

LHSH i uron mirëseardhjen haxhilerëve tonë dhe e lut Allahun e Madhëruar t'ua ketë pranuar haxhin


Editorial /

Letër e hapur drejtuar me rastin Kurban Bajramit

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë, duke parë përshtjellimin dhe debatin që është krijuar këtë vit dhe në vite të tjera, në mesin e muslimanëve të këtij vendi, për çështjen e ditës së Arafatit, Kurban Bajramit dhe atë të Fitër Bajramit, si dhe duke u nisur nga qëllimi i mirë, për zgjidhjen më të volitshme të këtij problemi, në përputhje me atë që na mëson feja jonë, si dhe nisur nga hadithi dhe parimi islam se 'feja është këshillë', i drejtohem institucionit të Komunitetit Musliman të Shqipërisë, të bëjë të gjitha përpjekjet e hapura serioze për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi njëherë e përgjithmonë.

Ne mendojmë se kjo çështje, shumë e rëndësishme dhe tepër e ndjeshme për besimtarët muslimanë, ka nevojë për një diskutim të gjerë fetar në mesin e hoxhallarëve të këtij vendi dhe kërkon një konsensus të gjerë mes tyre dhe nuk mund të mbyllet me thjesht një urdhër insitucional, i cili vetëm se do të thellojë edhe më tej çarjen në mes besimtarëve në vendin tonë dhe institucionit përfaqësues.

Si zgjidhje të këtij problemi ne këshillojmë që, KMSH të marrë për bazë kalendarin dhe ditët e Bajramit që përcaktohen në vendet e shenjta të Mekës dhe Medinës, duke qenë



se kjo pajton me një nga mendimet e njohura të fikhut islam për këtë çështje dhe shmang më shumë se çdo qëndrim tjetër përshtjellimin që krijohet herë pas here për këtë çështje. Pikërisht për këto dy arsye që ne përmendëm, një shumicë vendesh muslimane ndjekin atë që përcaktohet në vendet e shenjta, në veçanti për ditën e Arafatit dhe Kurban Bajramit. Kështu që, është ne nderin tonë si muslimanë, për shkak edhe të epokës së informacionit në të cilën jetojmë, të mos ndahemi nga kjo pjesë e rëndësishme e botës islame.

Së fundi, ne i këshillojmë besimtarët muslimanë të këtij vendi, që deri në zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi, të qëndrojmë të unifikuar në rang vendi për datat e festave islame, të falim bajramin me gjithë njerëzit e tjerë në shesh, ndërkohë që kurbanit lejohet të bëhet edhe në tre ditët në vazhdim dhe të shmangim qëndrimet dhe veprimet e skajshme intolerante mes nesh, pavarësisht faktit se cili është opinionimi i saktë fetar për këtë çështje, pasi përgjegjësia në këtë rast bie mbi tjetër kënd.

Gjejmë rastin të përshendesim vendimin e Bashkësisë Islame të Bosnjës, të cilët ndryshuan datën e Kurban Bajramit duke e unifikuar atë me pjesën tjetër të botës islame.

Lusim Allahun, që këshilla jonë të

gjejë zemra dhe arsye të hapura, larg paragjyqimeve dhe aludimeve që nuk na shkojnë për shtat ne si muslimanë.

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
 20/10/2012

Fq 4 / A pranon ndryshim harta e Islamit?!

Nga: Sultan ibn Abdurrahman el-Umeri

Fq 5 / Çlirimi i Kostandinopojës

Nga: Mustafa Tërniqi

Fq 6 / Bajrami i Kurbanit dhe debatet mbi datën

Nga Roald A. HYSA

Fq 7 / Islami lufton dembelizmin dhe papunësinë

Nga Sokol KONDAKÇIU

Komisioni i Përhershëm i Fetvasë

Fetva / Shlyerja e taksave me anë të kamatës

Mbretëria e Arabisë Saudite
Fetvaja nr. 13639/ V. 13 fq. 367

Pyetje: Ju bëj me dije se unë jam një student saudit që ndjek shkollën në Britani. Qeveria britanike ka vendosur taksa edhe për mua, si p.sh. taksa e rrugës, apo një taksë në masën 15% për mallrat që blej dhe që nuk janë ushqimore dhe rroba për fëmijë. Së fundi u vu në zbatim një taksë e re për shërbimet që ofron e bashkia e qytetit, si p.sh. arsimit, pastrimit, pishinat, parqet, vendet e argëtimit si dhe shërbimet sociale, ndërkohë që ne nuk përfitojmë nga shumica e këtyre shërbimeve, sepse në to gjen elementë që bien ndesh me fenë tonë islame. Ne përfitojmë vetëm nga arsimit, pastrimit dhe këndet e lojërave për fëmijë. Ne jemi të detyruar t'i paguajmë këto taksa të cilat shkojnë nga 3000 – 4000 rijal saudi në vit (rreth 500 – 680 £), pra rreth 300 rijal në muaj. Pyetja këtu sheh i nderuar është: a më lejohet mua të hap në bankë një llogari depozituese, pra llogari me kamatë (me fajde), llogari nga e cila

fitohet deri në 12 % në vit dhe nga këto fitime apo kamatë të paguaj një pjesë të këtyre taksave?

Duke u nisur nga fakti se unë nuk mund të veproj në lidhje me këtë çështje vetëm se duke qenë i qartë dhe i bazuar në argument, nisur nga fjala e Allahut: “kijeni frikë Allahun sa të keni mundësi” kërkoj nga ju të më ktheni një përgjigje ndaj letrës time sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që të dijë si të veprojë, sepse shlyerja e këtyre taksave do të rëndojë buxhetin tim financiar. Lus Zotin Bujar tu zgjasë jetën dhe tu jap shëndet dhe së fundi pranoni përshëndetjet e mia më të mira.

Përgjigje: Kjo gjë nuk të lejohet, pra të vendosësh paratë me kamatë dhe me të të shlyesh taksat që të kanë vënë si detyrim, sepse argumentet për ndalimin e kamatës janë të përgjithshme.

Suksesi është dhuratë e Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë për Profetin tonë Muhamed, familjen dhe shokët e tij.

Burimi: <http://www.alifta.net/fatawa/fatawaDetails.aspx?BookID=3&View=P>

age&PageNo=8&PageID=4902

Për të sqaruar më tepër këtë gjykim për lexuesit tanë këtu mund të shtojmë:

Së pari: Duhet ditur se kamata apo siç quhet ndryshe dhe fajde është e ndaluar me tekst të qartë dhe të prerë nga Kurani, po kështu edhe nga thëniet e Profetit (alejhi salatu ue selam) dhe ky është një gjykim për të cilin kanë rënë dakord myslimanët mes tyre ndaj të vepruarit me të nuk lejohet.

Së dyti: Interesi që merret nga bankat është kamatë, dhe si i tillë është haram. Në gjykimin islam ky fitim nuk është në pronësi as të bankës dhe as të atij që e merr atë, sepse ajo është pasuri e marrë nga njerëzit në mënyrë të padrejtë dhe duke qenë se është gati e pamundur të njihet se kujt i është bërë kjo padrejtësi, si e tillë ajo është pasuri publike dhe për këtë arsye ajo duhet të shkojë për interes publik dhe jo për interes individual. Fakti që me anë të parave të marra nga kamata dikush shlyen taksat do të thotë që ai po përfiton prej tyre në interes të tij, sepse ai në këtë rast po ruan pasurinë e tij me anë të haramit dhe kjo bie ndesh

me detyrimin që ka myslimani për të shpëtuar nga harami dhe për të mos përfituar prej tij.

Së treti: Nuk lejohet që dikush të shlyejë taksat qofshin edhe të padrejta me pasurinë e dikujt tjetër që i është marrë me padrejtësi, duke u nisur për këtë nga rregulli islam që thotë: “Dëmi nuk largohet me një dëm tjetër”. Pra, kushdo që beson se kamata është e ndaluar nuk i lejohet atij ta marrë atë për të shlyer me të taksat, qofshin këto edhe të padrejta, sepse e keqja nuk largohet me të keqe, dhe se këtu nuk hyn domosdoshmëria për ta konsideruar këtë veprim të lejuar.

Allahu e di më së miri.

Komisioni i Pyetjeve & Përgjigjeve pranë LSHS.

Për më shumë shih:

<http://www.islamweb.net/fatwa/index.php?page=showfatwa&Option=FatwaId&Id=125677>

<http://www.ferkous.com/rep/Bi58.php>

<http://www.darifta.org/majlesnew/d5.htm>

Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islam

Qiraja Financiare

(LEASING, qira që përfundon me pronësi të sendit)

Asambleja e Akademisë Ndërkombëtare të Fikhut Islam e dalë nga Organizata e Konferencës Islamike, në sesionin e saj të dymbëdhjetë të zhvilluar në Rijad, në Mbretërinë e Arabisë Saudite, në datat 25 Xhumadil Ahire – 1 Rexheb të vitit 1425 h. / 23-28 Shtator të vitit 2000 e.s., pasi mori në shqyrtim studimet e paraqitura në lidhje me temën “Qiraja Financiare (LEASING, qira që përfundon me pronësi të sendit)” dhe pas dëgjimit të diskutimeve që u zhvilluan rreth temës nga anëtarët e Akademisë, specialistë të fushës dhe nga fakih të tjerë, vendosi si më poshtë:

Qiraja Financiare (Leasing, qira që përfundon me pronësi të sendit)

Së pari: Rregullit që përcakton format e lejuara dhe të ndaluara, si vijon:

a) Kriteri ndalues: Të nënshkruhen dy kontrata të ndryshme në të njëjtën kohë, për të njëjtin send dhe për të njëjtin kohëzgjatje.

b) Kriteri lejuar:

1. Lidhja e dy kontratave të ndara dhe të shkëputura nga njëra-tjetra në kohë, që do të thotë nënshkrimi i kontratës së shitjes pas kontratës së qirasë, ose vendosja e premtimit se sendi do të kalojë në pronësi pas përfundimit të kohës së qirasë. Zgjedhja ka të njëjtat dispozita si premtimi.

2. Qiraja duhet të jetë reale dhe jo thjesht maskim për shitjen.

c) Garancia dhe sigurimi i sendit të dhënë me qira bie mbi pronarin dhe jo mbi qiramarrësin. Kjo do të thotë se qiradhënësi është që ai mbart përgjegjësinë për çfarëdo gjëje që i ndodh sendit, nëse kjo nuk ka lidhje me dëmtimin që mund t'i shkaktojë sendit qiramarrësi, për shkak të pakujdesisë apo për faj të tij. Qiramarrësi nuk ka asnjë detyrim nëse sendit i bie vlera. Nëse kontrata përfshin sigurimin e sendit të dhënë me qira, ky sigurim duhet të jetë “Siguracion Bashkëpunimi” i pranuar nga ana islame dhe jo “Siguracion Tregtie” (fitimprurës). Siguracionin duhet ta paguajë pronari qiradhënësi dhe jo qiramarrësi.(1)

d) Në kontratën e qirasë financiare (Leasing) duhen zbatuar dispozitat e qirasë, gjatë gjithë kohës së qirasë, ndërsa gjatë kalimit të sendit në pronësi duhen zbatuar dispozitat e shitjes.

e) Shpenzimet e mirëmbajtjes, që nuk kanë të bëjnë me vënie në punë të sendit, i takojnë qiradhënësit për gjatë gjithë kohës së qirasë dhe jo qiramarrësit.

Së dyti: Disa nga format e ndaluara:

a) Kur kontrata e qirasë, pas përfundimit të kohës së përcaktuar, përfundon në akt kalim pronësie të sendit, pa nënshkruar kështu një kontratë të re, në këtë rast është pagesa e qirasë ajo që konsiderohet si kosto e sendit, pra qiraja pas përfundimit të kohës shndërrohet vetvetiu në shitje.

b) Kur i jepet dikujt një send me qira

të përcaktuar, për një kohë të përcaktuar, dhe duke lidhur me personin në fjalë një kontratë shitjeje që varet nga dorëzimi i të gjitha kësteve të qirasë, për të cilat është rënë dakord brenda kohës së përcaktuar, ose e lënë në një kohë të ardhme.

c) Lidhja e një kontrate reale qiraje e shoqëruar kjo me shitje ku zgjedhja i takon qiradhënësit në një kohë të largët të përcaktuar (në kohën kur përfundon edhe kontrata e qirasë).

d) Këto janë pikat që përmbajnë fetvatë dhe vendimet e dala nga organizmat akademikë të ndryshëm, mes tyre edhe Këshilli i Dijetarëve të Mëdhenj në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

Së treti: Disa nga format e lejuara të kontratës:

a) Lidhja e një kontrate që i mundëson qiramarrësit të përfitoj nga sendi i marrë me qira, në shkëmbim të një pagesë-qiraje të përcaktuar në një kohë të përcaktuar, e shoqëruar kjo me një kontratë të veçantë dhurimi të sendit, për qiramarrësin, e varur kjo nga pagesa e plotë e qirasë, ose premtim dhurimi pas shlyerjes së plotë të qirasë, në përputhje kjo me vendimin e Akademisë Ndërkombëtare të Fikhut Islam në lidhje me dhurimin nr. 13 (1/3).

b) Lidhja e një kontrate qiraje ku pronari ia jep të drejtën e zgjedhjes qiramarrësit, pasi ai të ketë përfunduar nga shlyerja e të gjitha kësteve të qirasë që i takojnë për të dhënë gjatë gjithë kohës, për

ta blerë sendin e marrë me qira me çmimin e tregut, pas përfundimit të periudhës së qiradhënies, në përputhje kjo me vendimin e dhënë nga Akademisë Ndërkombëtare të Fikhut Islam nr. 44 (6/5).

c) Lidhja e një kontrate qiraje që i mundëson qiramarrësit përfitim nga sendi i marrë me qira, në shkëmbim kjo të një pagese-qiraje të përcaktuar, brenda një kohe të përcaktuar, e shoqëruar kjo me premtimin për t'ia shitur sendin e marrë me qira qiramarrësit, pasi ai të ketë shlyer të plotë qiranë, me atë çmim për të cilin kanë rënë dakord të dyja palët.

d) Lidhja e një kontrate qiraje, që i mundëson qiramarrësit përfitim nga sendi i marrë me qira, në shkëmbim kjo të një pagese-qiraje të përcaktuar, brenda një kohe të përcaktuar, dhe duke i dhënë qiradhënësi qiramarrësit të drejtën e zgjedhjes për ta bërë pronë të tij sendin e marrë me qira kur ai të dëshiroj, por kjo do të bëhet me një kontratë të re shitjeje me çmimin e tregut, në përputhje me vendimin e mësipërm të Akademisë nr. 44 (6/5), ose sipas asaj që bien dakord në momentin e shitjes.

Së katërti: Disa forma kontratash të Qirasë Financiare (Leasing) janë të debatueshme dhe për to ka nevojë për studim të më tejshëm dhe që do të paraqiten në sesionin e ardhshëm – në dashtë Allahu i Lartësuar.

Revista e Akademisë nr. 12 v. 1, fq 313.

Burimi: http://www.fiqhacademy.org.sa/

Oazi i shpirtit / Njerëzit janë si devetë...

Na përcillet nga Abdullah ibn Omeri (radijallahu anhuma), se i Dërguari i Allahut (alejhi salatu ue selam) ka thënë: “Njerëzit janë si devetë, në njëqind të tilla nuk gjen dot një që të mund t’i hipësh.” (Buhariu & Muslimi)

Ky hadith tregon një realitet dhe përmban gjithashtu një udhëzim të dobishëm. Për sa i përket realitetit Profeti (alejhi salatu ue selam) na tregon se natyra e mangët është ajo që prek shumicën e njerëzve, dhe se njerëzit e plotësuar janë të pakët, njëlloj si në një tufë të madhe me qind deve. Nëse kërkon në mes njerëzve dikë që vlen për mësimdhënie, fetvadhënie, lider, apo për t’i dhënë poste përgjegjësie, të madh apo të vogël, apo funksione të rëndësishme, gati nuk do të mund të gjesht mes tyre dikë që ta kryejë atë siç duhet. Dhe kjo është realitet, sepse njeriu në përgjithësi është i padrejtë dhe i paditur, dhe padrejtësia e padituria janë mangësi që pengojnë njeriun të jetë i plotë.

Për sa i përket udhëzimit, ky hadith përmban udhëzim nga Profeti (alejhi salatu ue selam) për mbarë umetin që ata të përpiqen në përgatitjen e njerëzve të aftë për të përballuar përgjegjësi të rëndësishme dhe funksione që mbartin rëndësi publike. Vetë Allahu ka udhëzuar në këtë gjë kur thotë: “Nuk është mirë që besimtarët të shkojnë në luftë të gjithë njëherësh, por prej çdo bashkësie, një

grup të mbetet mbrapa, që të thellohet në mësimin e fesë dhe kështu të këshillojë popullin e vet mbasi të kthehet nga lufta, që t’i frikësohet Allahut.” (Teube:122) Në këtë ajet Zoti urdhëron që ata të cilët shkojnë në luftë duhet të jetë një grup i mjaftueshëm njerëzish, në mënyrë që pjesa tjetër të merret me dije duke ndihmuar kështu njeri-tjetrin. Urdhri

i Allahut për mbajtjen e përgjegjësie publike kërkon emërimin e njerëzve të duhur që duhet të plotësojnë kriteret për të qenë të plotë. Njerëzit kanë nevojë të domosdoshme për poste që do të mbartin përgjegjësitë fetare dhe ato jofetare, sepse këto janë nevojat jetike për ta. Dhe këto nevojat nuk mund të përmbushen vetëm nëse në krye të këtyre punëve vihen

njerëzit e duhur dhe të aftë për to dhe natyrisht që kjo gjë kërkon punë që këto cilësi të arrihen, kuptohet për atë që kjo është e mundur, Allahu thotë në Kuran: “frikësojuni Allahut sa të mundeni” (Tegabun:16)

Shkëputur nga “Behxhetu Kulubul Ebrar” të Shejh Abdurrahman Sadi, fq. 255-256



Pesë gjëra që të largojnë nga mëkatimi ndaj Allahut (bisedë e një asketi me një mëkatar)

Një njeri shkoi tek Ibrahim ibën Ed`hemi –Allahu e mëshiroftë-, i cili vërtet ishte nga shëruesit e zemrave, dhe iu drejtua:

Njeriu: Me të vërtetë unë e kam ngarkuar veten së tepërmi me mëkate. Më trego çka më pengon dhe largon nga mëkatet?

Ibrahimi: Nëse i përmbahesh pesë gjërave, kurrsesi nuk do të jesh prej mëkatarëve.

Ishte tepër i pasionuar për të dëgjuar këshillën e tij.

Njeriu: Më trego ç`ke për të më thënë, o Ibrahim!

Ibrahimi: Kur dëshiron t’i mëkatosh Allahut, mos ha asgjë nga rrisku i Tij!

Njeriu i habitur e pyeti:

Si po thua kështu, o Ibrahim, kur të gjitha furnizimet janë prej Allahut?!

Ibrahimi: Ndonëse ti po e di këtë, Ai prapë po ta mundëson të hash prej rriskut të Tij, kurse ti po ia kthen me mëkat.

Njeriu: Jo, o Ibrahim, tregoma të dytin!

Ibrahimi: Kur dëshiron t’i mëkatosh Allahut, atëherë mos bano në tokën e Tij.

Njeriu u habit edhe më shumë se më parë.

Njeriu: Si po thua kështu, o Ibrahim! E tërë toka është pronë e Allahut.

Ibrahimi: Ndonëse ti po e di këtë, Ai prapë po ta mundëson që të banosh në tokën e Tij, kurse ti po ia kthen me mëkat.

Njeriu: Jo, o Ibrahim, tregoma të tretin!

Ibrahimi: Kur dëshiron t’i mëkatosh Allahut, atëherë gjeje një vend ku nuk do të të shihte Allahu, e aty mëkatoji.

Njeriu: Si po thua kështu, o Ibrahim! Ai është më i Dituri për fshehtësitë (di të dukshmen dhe të padukshmen), i dëgjon rrapëllimat e buburrecit në gurin e zi e në natën e errët.

Ibrahimi: Ndonëse ti po e di këtë, vallë a të nxitë diçka që ta kundërshtosh?!

Njeriu: Jo, o Ibrahim, tregoma të katërtin!

Ibrahimi: Kur të të vijë Meleku i Vdekjes, për të ta marrë shpirtin, thuaji: “Ma shtyj afatin e exhelit.”

Njeriu: Si po thua kështu, o Ibrahim! Allahu i Lartësuar thotë: “Çdo popull ka afatin e vet. Kur t’i vijë koha e fundit, ata nuk mund ta shtyjnë, qoftë edhe për një çast dhe as nuk mund ta shpejtojnë.” (El-Araf: 34)

Ibrahimi: Kur po e di këtë, si po e shpreson shpëtimin?!

Njeriu: Po, tregoma të pestin, o Ibrahim!

Ibrahimi: Kur të të vijë zebaninjte –të cilët janë meleket e Xhehenemit- për të futur në Xhehenem, mos shko me ta!

Njeriu me t’i dëgjuar këto pesë këshilla, tha duke qarë: “Mjafton, o Ibrahim!” Unë po i kërkoj falje Allahut dhe tek Ai po pendohem.- Ai iu qas ibadetit derisa u largua nga kjo dynja.

Përkthyen:

Jeton dhe Burim KOÇINAJ

Kontrolli: Hoxhë Lulzim Susuri

Një këshillë e vyer

Nga Ulvi Fejzullahu

Mos e harro këtë lutje:

Ebu Derdai tërë natën u fal duke qarë dhe përsëriste vetëm një lutje: “O Allah ashtu si përsose krijimin tim, përsose (bëje të mirë) sjelljen time.” Vëlla/motër!

Ebu Derdai e kaloi natën duke u lutur vetëm më këtë lutje, PSE?

Mos harro, se me moral të mirë hyn në xhenet, atëherë:

- Mos harro t’i përmirësosh sjelljet e tua.
- Mos harro t’i përmirësosh qëndrimet e tua.
- Mos harro t’i përmirësosh shprehjet e tua.
- Mos harro t’i përmirësosh miqtë dhe shokët e tu.
- Mos harro t’i përmirësosh dhe korrigjosh temat, shkrimet postimet në facebook.

Dhe në fund, mos e harro këtë lutje:

“O Allah ashtu si përsose krijimin tim, përsose (bëje të mirë) sjelljen time.”

Analiza / A pranon ndryshim harta e Islamit?!

Nga: Sultan ibn Abdurrahman el-Umeri

Islami nuk është një grumbull dispozitash, të hapërdara sa andej këndeje, që kërkon prej njerëzve vetëm tu përmbahen atyre. Ai nuk është as parcela të shpërndara në tokë, të cilat njeriu mund t'i zhvendosë si të dojë. Nuk është as objekt me shtresa, të cilat mund të ndahen sipas dëshirës. Islami është një ndërtesë solide, e përfunduar dhe harmonike me pjesët e tij, është një entitet ku përbërësit e tij ndërfiten me njeri-tjetrin dhe ku çdo gur është i vendosur në vendin e tij më të përkryer, me urtësi dhe kujdes. Ligjvënësi i Urtë në ndërtimin e rendit islam nuk është mjaftuar vetëm me vendosjen e dispozitave të ligjit islam, por i ka kushtuar rëndësi edhe dizenjimit preciz të hartës së këtyre dispozitave, në mënyrë të atillë ku çdo pjesë në të është vendosur në vendin e duhur dhe në mënyrë më të bukur.

Allahu i Lartësuar, është Ai që krijoi gjithësinë dhe përsosi çdo pjesë të saj dhe çdo gjëje në të i dha masën e saj, është Ai që e përsosi ndërtesën e hartës së Islamit dhe e konsolidoi rendin e tij hierarkik dhe çdo gjëje i dha masën e saj.

Forca e Islamit, bukuria dhe veçantia e tij nuk qëndron vetëm te dispozitat e tij ligjore, por te ndërtesa e tij e bukur dhe harta e tij e dizenuar me përsosmëri, finesë dhe hijeshi vezulluese.

Ne me Islamin, nuk jemi përpara disa dispozitave ligjore të shkëputura mes tyre, por përpara një harte gjigande për të cilën jemi urdhëruar të mos ndryshojmë asnjë shenjë të saj, por t'i përmbahemi kufijve dhe treguesve të saj. Si muslimanë që jemi, ashtu siç e kemi për detyrë t'i përmbahemi dispozitave të sheriatit, po ashtu e kemi për detyrë të ruajmë hartën e Islamit ashtu siç e ka dizenuar Profeti (alejhi salatu ue selam), duke mos i shtuar dhe hequr asgjë dhe duke mos i ndryshuar vendin pjesëve të saj. Kuptimi i hartës së Islamit bazohet në parim tek përcaktimi i objektivit primar të mesazhit të fesë, që padyshim është përmbushja e adhurimit të Allahut në tokë. Argumentet për këtë janë të shumtë, po kështu edhe për renditjen e përparësive ligjore të fesë dhe njohjen e çdo niveli të saj. Në momentin që ndodh një problem në kuptimin e objektivit primar të mesazhit islam ose në renditjen e përparësive të tij ligjore, padyshim që ky problem do të reflektohet në pamjen e hartës së dizenuar nga Profeti (alejhi salatu ue selam).

Procesi i kuptimit të Islamit dhe realitetit tërësor të mësimave të tij, është një domosdoshmëri dhe ka një rëndësi të veçantë, por në të njëjtën kohë është edhe një proces i rrezikshëm, është një punë madhështore dhe gjigande, por edhe skajshmërisht e ndjeshme, sepse saktësia e këtij përfytyrimi dhe gabimi në të reflektohet te dimensionet e pjesëve të tjera të fesë dhe tek natyra e marrëdhënieve në mes tyre. Nëse ky përfytyrim është i gabuar edhe pamja e hartës së Islamit dhe godinës së tij do të jetë e gabuar.[1]

Edhe pse Sheriati e ka sqaruar objektivin primar të tij në mënyrë tepër të qartë dhe ka dizenuar rendin hierarkik të përparësive të tij shumë qartë, përsëri

ka ndodhur që hulumtues të ndryshëm të gabojnë në përcaktimin e tij. Shkaqet për këtë janë të shumtë, por nga më të rëndësishmet janë:

-futja në kuptimin e Islamit nga dritarja e ndreqjes së gabimeve të pjeshme dhe zhytja në to,

-hyrja nga dritarja e mbrojtjes së Islamit nga akuzat e kundërshtarëve të tij për të,

-futja nga dritarja e trysnisë së momentit,

-hyrja nga dritarja e ndikimeve të organizatave që kanë përparësi të ndryshme nga përparësitë e rendit islam.

Këto shkaqe apo disa prej tyre e përqendrojnë vëmendjen drejt asaj që i përshtatet në hartën e Islamit, duke i dhënë kështu asaj përparësi dhe duke formësuar kështu me anë të saj kuptimin e Islamit, objektivat dhe renditjen e përparësive të tij në përputhje me këtë vështrim.

Nuk është fare e vështirë të gjejmë shembuj real të tillë që zbulojnë shenja të gabimeve në të kuptuarin e mesazhit të Islamit dhe përcaktimin e treguesve në hartën e tij.

Epoka jonë karakterizohet nga shkrimet e shumta, të cilat flasin për kuptimin e realitetit të Islamit dhe mesazhin e tij në këtë botë, rreth përbërësve, veçorive dhe përparësive të tij. Në këtë drejtim gjejmë njerëz nga spektra dhe grupime të ndryshme, qofshin këta islamik, orientalistë e të tjerë, që parashirojnë vizione dhe ide të ndryshme rreth temës. E gjitha kjo ka rezultuar në atë që mund të quhet "rrëmuja e interpretimit të Islamit".

Kur disa islamik vunë re sesi bota islame vuante nga prapambetja qytetërimore dhe mungesa e zhvillimit dhe donin ta ndreqnin këtë gjë, u kapën pas aspektit të zhvillimit të botës dhe e shndërruan atë në përfaqësues të objektivit primar të mesazhit të Islamit. Funkcioni primar i njeriut në këtë jetë ishte pra, ndërtimi i qytetërimit në këtë botë dhe misioni primar i Islamit ishte bërja e njeriut.

Kur disa islamik vunë re përmasat tragjike të prapambetjes në fushën e dijes, qytetërimit dhe shoqërisë, e donin ta shpëtonin umetin e tyre nga kjo prapambetje, i kushtuan rëndësi çështjes së ndryshimit duke e ngritur lart këtë gjë, sikur kjo të ishte objektivi primar i mesazhit të Islamit dhe se Allahu e kishte dërguar Profetin e Tij për të ndryshuar shoqëritë e ndryshme njerëzore.

Kur disa mendimtarë islam u përballën me strukturën e ngrirë të mendimit në botën islame, e cila ia kish mbyllur derën ixhtihadit dhe kish ngushtuar rrugët e dijes dhe njohjes dhe i kish mohuar arsyes rolin e saj në të kuptuarin e fesë dhe deduksionin e dispozitave, ata donin t'i jepnin zgjidhje këtij problemi, ndaj dhe nuk u ndalën te kufijtë e raciales, por e kaluan atë duke i dhënë arsyes një rol tepër të lartë argumentimi, aq sa ajo qëndronte edhe mbi tekstet e shenjta të Fesë.

Kur disa reformatore vunë re deviacionin politik që vegjetonte në shoqëritë islame

dhe dëmin që ai u kish sjellë dhe donin ta shpëtonin umetin e tyre nga kjo gjendje, filluan të thonë se, objektivi primar i mesazhit të Islamit është revolta kundra rendeve politike të padrejta, kthimi i të drejtave në vendin e vet dhe themelimi i një rendi të drejtë islam.

Një nga dëshmitë më të qarta, që provojnë këtë realitet, është edhe perceptimi mbi të cilin është ngritur xhemati islamik në Indi, me udhëheqjen e Prof. Ebu el-Ala el-Meududit. Ai thekson në mjaft libra të tij se, objektivi primar i mesazhit të Islamit është ngritja e qeverisjes islame në tokë dhe se, qëllimi i besimtarit në këtë qeverisje është vënia në zbatim e ligjeve të Fesë. Pikërisht për këtë arsye në disa shkrime të tij Medudi vlerëson se, thelbi i hyjnitetit të Zotit qëndron te pushteti dhe qeverisja dhe për pasojë edhe adhurimet praktike, ai i konsideron si mjete për përmbushjen e këtij objektivit. Namazi, zekati, agjërimi dhe haxhi, ishin pra për Meududin norma stërvitore që e përgatisnin njeriun për të kryer detyrën e ngritjes së qeverisjes islame në tokë![2]

Bazamenti i përbashkët i të gjitha këtyre perceptimeve është, përpjekja për të interpretuar mesazhin primar të Islamit me çështje të sakta fetare, por në realitet ai nuk është objektivi primar i Islamit dhe as peshorja me të cilën gjykohet harta e tij dhe as ideja tërësore e universale e tij.

Nuk vihet në dyshim se, ndërtimi i kësaj bote, domosdoshmëria e ndryshimit, njohja raciale apo rëndësia rendit të drejtë politik, janë çështje të kërkuara nga feja dhe janë pjesë përbërëse e hartës së saj, por ato nuk përfaqësojnë objektivin primar të mesazhit të Islamit dhe nuk janë urtësia e tij universale dhe as qëllimi primar i çdo muslimani në jetë.

Problemi pra, nuk qëndron në faktin se këto interpretime nuk janë të sakta në vetvete dhe as në faktin se ato zënë një vend të rëndësishëm në hartën e Islamit dhe as në domosdoshmërinë e përqendrimit në to dhe dhënies rëndësi dhe as te ndriçimi i tyre dhe nxitja për t'i trajtuar ato dhe as te përdorimi i fjalëve të forta për të ftuar në to, jo, asnjëra nga këto nuk përbën problem, por problemi qëndron kur ato zhvendosen nga vendi i tyre në hartën e Islamit, kur ato marrin vend më të lartë se ai që u takon në fakt, si dhe tek përdorimi i fjalëve që të lënë përshtypjen se këto çështje zënë vendin kryesor në majën e hierarkisë së Islamit.

Rrezikshmëria e këtyre interpretimeve qëndron në faktin se ato lidhen me interpretimin e realitetit tërësor dhe universal të mesazhit islam dhe nuk është si gabimi në kuptimin e një pjesë të caktuar të Islamit, si p.sh. gabimi në çështjen e gjykimit të atij që braktis namazin apo çfarë gjykimit për namazin përshëndetës të xhamisë. Ky gabim ka të bëjë me tërësinë e përcaktimit, të ndërtimit hierarkik të strukturës së fesë dhe të shpirtit të saj. Është e qartë se, nëse ndryshon këndvështrimi i perceptimit të realitetit tërësor, kjo ndikon në pozicionin

e pjesëve dhe renditjen e niveleve të tyre. [3] Në këtë rast disa pjesë zhvendosen nga vendi i tyre në hartë, ose duke u ngritur lart, nëse kemi përputhje me objektivin primar që propozohet, ose duke u ulur poshtë, nëse objektivi nuk është i tillë. Në të dyja rastet imazhi i hartës së Islamit nuk do të mbetet ashtu siç është. Nëse dikush kërkon të ndryshojë p.sh. strukturën skeletore të elefantit, duke mos shtuar dhe as hequr asgjë në fakt, por duke ndryshuar pozicionin e pjesëve të tij, a do të mbetet në këtë rast pamja e elefantit ashtu siç ajo është, apo do të ndryshojë dhe pamja e tij do të deformohet?

E njëjta gjë do të ndodh edhe për atë që ndryshon rendin në hartën e Islamit, duke ngritur lart disa pjesë, aq sa të zënë kreun e hierarkisë së tij apo duke i ulur disa pjesë të tjera nga vendi i përcaktuar i tyre, padyshim që kjo do të ndryshojë pamjen e hartës së Islamit dhe formën e saj.

Këto interpretime –të gabuara- paraqesin një perceptim që përfshin të gjitha pjesët e fesë, por duke lëvizur nga vendi i tyre origjinal ato kanë krijuar për pjesët e fesë një renditje jo të saktë, të kushtëzuar nga situata të veçanta dhe jo nga situata normale, mbi të cilën dhe është bazuar ndërtimi i Sheriatit islam, pamja dhe renditja e tij.

Nuk ka dyshim se në këtë epokë që jetojmë kemi nevojë të domosdoshme të përcaktimit të përfytyrimeve të sakta islame dhe jemi të detyruar të zbulojmë hartën e Islamit ashtu siç e dizenuoi Profeti (alejhi salatu ue selam), duke larguar prej saj çdo cen që i është ngjitur përgjatë historisë. Kjo hartë është padyshim rripi i sigurimit që na shpëton nga dallgët tronditëse të ideologjive njerëzore, ajo është busulla që na tregon drejtimin e saktë mes humbësive të sorollatjes njerëzore. Por, ne veç kësaj në të njëjtën kohë, kemi nevojë të eliminojmë të gjitha zgavrat që të shpien në gabime në kuptimin e realitetit universal të Islamit.

Prof. Sejid Kutbi ka tërhequr vëmendjen rreth domosdoshmërisë së kësaj çështje dhe ka theksuar se procesi i zbulimit të hartës së Islamit kërkon prej nesh të mos "evokojmë para nesh devijimet e caktuara të mendimit apo realitetit islam dhe më pas i gjithë preokupimi ynë të zhytet në to, aq sa kritika dhe ndreqja e tyre të bëhet tërësia e lëvizjes dhe energjive tona, që ne japim për të përcaktuar veçoritë e perceptimit islam dhe përbërësit e tij... Por, ne duhet të përpiqemi në përcaktimin e të vërtetave të këtij perceptimi në vetvete, ashtu siç i ka sjellë Kurani fisnik, të plota, përmbledhëse, të ekuilibruara dhe harmonizuara, si harmonia e kësaj gjithësie dhe ekuilibri i saj...

Ndryshe, evokimi i një devijimi të caktuar apo një mangësie çfarëdo dhe preokupimi i tërësishëm në largimin e saj dhe riformulimi i vërtetësive të Islamit për t'u përgjigjur këtyre devijimeve, është një rrugë tepër e rrezikshme, që prodhon devijim të ri në perceptimin islam, për të eliminuar devijimin e vjetër. Devijimi mbetet devijim në të gjitha rastet." [4]

Opinion / Çlirimi i Kostandinopojës

Nga: Mustafa Tërniqi



Data 29 Maj na kujton një ngjarje shumë të rëndësishme dhe tepër të madhe. Pikërisht më 29 Maj të vitit 1453, pas 50 ditësh rrethim, Sulltan Muhamed Fatihu futet triumfues në Kostandinopojë duke bërë të ndryshojë rrota e historisë botërore.

Sipas shumë kronistëve perëndimorë, Muhamed Fatihu (Mehmet Fatihu) është quajtur si Mehmet pushtuesi. Ndërkohë fjala "Fatih" do të thotë çlirues dhe jo pushtues. Ai ishte çlirues për vetë banorët e Kostandinopojës, të cilët bashkë me shumë prej klerikëve të lartë, preferonin më shumë autoritetin e Sulltan Mehmet Fatihut, se sa zgjedhën e rëndë perandorake, që ua kishte marrë frymën nënshtetasve të vet me taksa të larta e padrejtësi të pafundme. Po ashtu rënia e Kostandinopojës ishte çlirim dhe sihariq për muslimanët, të cilët prisnin në çdo moment përmbushjen e profecisë së Profetit Muhamed (alejhis-salatu ues-salam) i cili kishte paralajmëruar që herët për çlirimin e Kostandinopojës nga muslimanët.

Sido që të jetë, biem ose jo dakord, nëse edhe vetë Sejid Kutbi pati sukses në përmbushjen e kësaj metodologjie apo ra edhe ai vetë qe viktimë e asaj që kishte paralajmëruar; gjithsesi çështja për të cilën tërhoqi vëmendje mbetet çështje qendrore dhe tepër e rëndësishme dhe e rrezikshme.

Çështja e parë të cilës duhet t'i përmbahemi në zbulimin e hartës së Islamit është, dallimi në mes së vërtetës së objektivit që solli Islami për të përmbushur, që është edhe shpirti i mesazhit dhe mendimit të tij universal dhe përbërësve shoqëruar të domosdoshëm të këtij objekti.

Tekste të shumta të Fesë provojnë se objektivi primar –fjala "primar" do të thotë se ka edhe objektiva të tjerë, por që nuk janë primar- i saj është përmbushja e adhurimit të Allahut të Lartësuar në tokë dhe rregullimi i marrëdhënieve në mes njeriut dhe Zotit të tij. S'ka pikë dyshimi se ky mesazh kërkon domosdoshmërisht rregullimin e jetës njerëzore në këtë

Ndryshe nga ç'pretendojnë shumë historianë Muhamed Fatihu nuk ka bërë masakra, e as gjakderdhje të panevojshme. Gjithashtu nuk i ka detyruar të krishterët të pranojnë Islamin, por i ka lënë ata të lirë të ushtrojnë ritet e tyre fetare lirisht. Këtë e tregon vetë fakti se fill pas rënies së Kostandinopojës më 29 Maj 1453, më 1 Qershor u shpall patriark Genadiozi, njeriu i besuar i sulltanit. Që nga ai vit e në shekujt e mëvonshëm Patriarkana e Stambollit kishte pushtetin e plotë mbi të krishterët e Ballkanit. Në juridiksionin e Patriarkanës përfshiheshin arsimit, martesat, familja, trashëgimia, etj... Patriarku u shpall Vezir në rangun e një pashai të lartë.

Ndërsa për sa i përket faktit se Muhamed Fatihu nuk ka bërë masakra me popullatën bizantine, atë e dëshmojnë shumë prej historianëve objektivë. Për shembull, kronisti Niqitas Akonimati bën një dallim tepër të madh mes kryqtarëve dhe osmanlive. Ai tregon se kryqtarët kur vërshuan në Kostandinopojë më 13 Pril të vitit 1204, plaçkitën shtëpitë dhe kishat, thyen imazhet e shenjta dhe flakën reliket e martirëve në vende të ndyra. Qyteti i tërë s'ishte më veçse dëshpërim, lot, britma, rënkime. Ndërsa kur flet për futjen e Osmanlive në qytet shprehet: "Ata, të paktën nuk na i përdhunonin gratë... nuk i katandisnin banorët në mjerim, nuk i zhvishnin lakuriq në mes të rrugës, nuk i bënë të vdisnin nga uria e nga zjarri..." (Ogyst Baji, "Perandoria e Bizantit" fq. 230-231.)

Kjo ka qenë karakteristikë e muslimanëve në përgjithësi, madje në shumë vende joislame përveç Perandorisë Bizantine, ku taksat e larta, varfëria, padrejtësitë, vrasjet dhe degjenerimi kishin arritur kulmin muslimanët janë pritur si shpëtimtarë. Kjo sepse synimi i vetëm i muslimanëve ishte çlirimi i popujve dhe prezantimi i tyre me konceptin e vërtetë mbi Krijuesin. Thënë ndryshe, për t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë, nga injoranca në dituri, për të kuptuar qëllimin e vërtetë

botë dhe rregullimin e marrëdhënieve të tij me ekzistencën, kërkon prej njeriut të ndërtojë këtë botë dhe të ndryshojë gjendjen e korrumpuar në të...etj. Por, të gjitha këto mbeten pjesë përbërëse të objektivit primar dhe konsiderohen objektiva pasues të tij, por jo më të lartë apo të njëjtë me të.

Ndjeshmëria e lartë, e rëndësishë së devijimit, të një ideje dhe pasojat që vijnë prej saj, nuk e justifikojnë për ne faktin, që gjatë ndreqjes së saj, t'i japim asaj një vend më të lartë sesa ajo zë në Fenë islame, nuk përligj për ne që t'i ndërrojmë asaj vendin që ajo zë në hartën e Islamit.

Nëse imagjinojmë p.sh. një kohë ku është përhapur imoraliteti në të asnjëherë tjetër, dhe një grup njerëzish që duan ta ndreqin këtë problem, duke e vendosur këtë në krye të përparësive të tyre... Ata kanë gjithë të drejtën ta konsiderojnë këtë objektivi primar të tyre, e ndoshta kjo është detyrë për ta, por ama nuk u lejohet atyre tu paraqesin të tjerëve se, objektivi kryesor i Profetit (alejhi salatu ue selam)

të jetës dhe për të njohur Krijuesin, ashtu siç e meriton. Kurse për vetë osmanlitë, Sami Frashëri në: "Përhapja e Islamit" fq. 14 shkruan: "Mirëpo, muslimanët në këtë kohë kishin nevojë për një personalitet madhështor dhe të forte, që do t'i mbronnte nga invadimi i armiqtë dhe do t'i siguronte nga trazirat e brendshme. Kjo dëshirë u sendërtua me paraqitjen e shtetit Osman. Njerëzit e këtij shteti shqueshin me trimëri dhe konsekuencë fetare, ishin ithtarë të drejtësisë dhe objektivitetit. Nuk bënë krime, as gjakderdhje pa arsye, siç patën vepruar shumica e qarqeve sunduese. Lodhjet e luftës dhe vështirësitë e rrugës i përballuan vetëm për përhapjen e Islamit, për mbrojtjen e muslimanëve dhe madhërimin e fjalës së Allahut. Shpresa e tyre ishte e kulluar. Qëllimi i veprave të tyre ishte fitimi i kënaqësisë së Allahut, duke u sjellur dobi muslimanëve." E pra, nuk është e vërtetë që Islami është përhapur me shpatë. Madje është shpata ajo që ka penguar sa herë përhapjen Islamit. Nga ana tjetër, nëse demokracia u imponohet popujve si zgjidhja më e mirë, ku në shumicën e rasteve antivlerat serviren si vlera, shthurja dhe degjenerimi paraqitet si emancipim, liria e tepruar si zhvillim dhe shfrytëzimi i popujve si integritet, atëherë vlerat universale të Islamit, me të vërtetë janë çlirim. Këtë e kanë dëshmuar muslimanët sa herë që ata kishin fuqinë në dorë. Ata kudo që shkelën, duke pasur për qëllim të çlironin dhe jo të pushtonin popujt, dhuruan moral, drejtësi, kulturë dhe themeluan e ngritën qytete të reja e të shumta për atë kohë, por ndërtonin spitale, jetimore, qendra rehabilitimi, institucione zyrtare shtetërore e private, gjykata, pallate, kopshte, punishte, fabrika, tregje, qendra biznesi, shkolla, institute, biblioteka, madje dhe universitete. Muslimanët nën pushtetin e tyre sollën stabilitet e siguri dhe ishin të parët që ftuan në vëllazërimin e

ishte lufta kundra imoralitetit dhe se Allahu i Madhëruar i dërgoi Profetët për të përmbushur këtë objektivi, sepse kjo bie ndesh me argumentet e dukshme dhe të qarta të Fesë.

Origjina e problemit metodik në këtë lloj predikimi që përmendëm, qëndron tek mos dallimi në mes gjendjes së jashtëzakonshme dhe asaj normale mbi të cilën ndërtohet Feja. Në rastet kur kemi devijim dhe largim nga e vërteta, është detyrë që ligjërimi të përqendrohet dhe t'i jepet përparësi rregullimit të problemeve të aktualitetit dhe luftës ndaj mjeteve që i mbajnë në jetë këto probleme, por kjo natyrisht që dallon në një situatë normale në të cilën është detyrë të shihen me kujdes vetë argumentet e Fesë, pa marrë parasysh diçka tjetër.

Problemi qëndron në faktin se, disa nuk bëjnë dallim në mes përparësive të projekteve të tyre, që i nënshtrohen situatave të kufizuara historike dhe shoqërore dhe në mes përparësive që ka sjellë vetë Feja për të përmbushur në

kombeve pa dallim racash, ku çdo njeri merrte atë që meritonte, larg racizmit dhe shfrytëzimit. E kur muslimanët u dhanë pas të mirave të kësaj bote, u përçanë mes veti dhe u larguan nga feja, merituan t'u hiqej fuqia që kishin dhe prestigji që gëzonin. Mirëpo kjo ishte njëra nga urtësitë e Allahut ku bota kuptoi se nëse fuqia do të jetë në duart e jo muslimanëve në tokë do të mbisundojë padrejtësia. Vetëm me luftën e parë dhe të dytë botërore, u vranë miliona njerëz. Për t'u mos u mjaftuar me kaq miliona të tjerë u zhdukën dhe u eliminuan fill pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Ata u vranë në emër të së mirës. E habitshme është se të gjitha ndodhën në shek. XX, në shekullin e zhvillimit dhe përparimit, ku politikat shfrytëzuese çmoheshin më shumë se jeta e njerëzve. Chantal Millon-Delsol në "Idetë politike të shekullit XX" fq. 7-8 thotë: "Politika s'ka qenë kurrë ndonjëherë deri në këtë pikë në shërbim të ideve. Ajo shkatërron shoqërinë aktuale për të arritur një shoqëri të përsosur... Privilegji që iu akordua abstragimit, i nxori shoqëritë zbuluar dhe i zhveshi njerëzit nga dinjiteti i tyre. Asnjë epokë tjetër s'ka qenë, për nga racionalizmi i tejskajshëm, kaq ç'njerëzor në thelb. Epokë gabimesh: shpresat për një shoqëri të përkryer çuan në shtypje dhe politika nënshtroi shpejt atë që pretendonte të çlironte... Duhej besuar se gjithçka është e mundur për të vënë në jetë të pamundurën... Shekulli XX gabon në dy kuptime: përbuz qenien, sepse gabohet mbi qenien". E gjithë kjo i bën njerëzit e mençur të kuptojnë me të vërtetë, se çfarë humbi bota me rënie e muslimanëve dhe se çfarë do të thotë të konsiderohet e pavërteta e vërtetë. Sidoqoftë Profeti Muhamed (alejhis-salatu ues-salam) na ka lajmëruar se e ardhmja u përket muslimanëve, çka do të thotë se me dështimin e të gjitha ideve dhe sistemeve politike njerëzore, Islami është alternativa e vetme për njerëzimin.

këtë botë, duke i shndërruar përparësitë e projektit të tyre stacionar në përparësi të vetë Islamit! Këtu qëndron edhe rreziku dhe keqkuptimi i hartës së Islamit.

Parimisht, nuk ka asnjë pengesë që kush dëshiron, prej reformatorëve, të përcaktojë përparësitë, të cilat ai i sheh si më të nevojshme për t'u kushtuar, e që kanë nevojë të ndreqen në botën islame, qofshin këto përparësi në fushën e thirrjes islame, në besim apo në shoqëri. Njerëzit që punojnë në fushën e thirrjes dhe mendimit islam duhet ta kuptojnë mirë këtë larmi, madje duhet ta mbështesin dhe përkrahin atë dhe atëherë diskutimi duhet të kufizohet vetëm në faktin, nëse ky përcaktim i këtyre përparësive është i saktë apo jo? Por, ama nuk është aspak e drejtë që këto prioritete të ngrihen në pozitë të atillë që të zënë vendin e vetë mesazhit të Islamit.

Burimi: <http://taseel.com/display/pub/default.aspx?id=2066&ct=21&ax=5>
Përktheu: J. Topulli

Analiza / Bajrami i Kurbanit dhe debatet mbi datën

Nga Roald A. HYSA

*(Shumë veta ngritën pyetjen kësaj radhe "Kur është Bajram?", por nuk ishte ky thelbi i vërtetë për të cilin u shqetësuan njerëzit. Në fakt mungesa e unifikimit të datës nxorri në pah probleme të tjera të gjeneruara edhe nga dy qendrat më autoritative të botës muslimane. Asnjë nuk u përpoq t'i kthehej thelbit të kësaj pyetje ashtu si i takon!)**

Edhe një herë në pak vite u ngatërruam me festën e Bajramit të Kurbanit, si dhe për nisjen e muajit të Madhnueshëm të Ramazanit. Rëndom palët në konflikt ishin të ashtuquajturit "Turq" dhe "Arabë". Ky është një rast i përsëritur, i cili nuk shfaqet për herë të parë përpara të gjithë muslimanëve, si dhe përpara dijetarëve muslimanë, të cilët e kanë barrën kryesore të zgjidhjes së këtyre meseleve. Por këto fjalë dhe mesele janë sqaruar tashmë me kohë, po ashtu edhe për rastin tonë hoxhallarë me emër u shprehën rreth vendimit të marrë nga KMSH për fillimin e ceremonialit të Bajramit të Kurbanit më 25 tetor, kudo ku ata e patën mundësinë për ta bërë këtë me argumentet "në favor" të datës 25 (çuditërisht ata që u shprehën nëpër blogjet sociale dhe FCB, apo edhe në këshillimet e tyre fetare individuale apo në grupe të mëdha ishin ata hoxhallarë, që janë etiketuar rëndom si "vehabi"). Janë pikërisht këta hoxhallarë, të cilët u shfaqën në masë me të njëjtin qëndrim, që e qetësuan xhematin dhe pamë fotografimin e zakonshme tashmë të Bajramit në sheshin që nis nga Ministria e Mbrojtjes dhe e Brendshme e deri tek Ura e Madhe në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Gjithsesi ajo çka u reflektua në këto ditë ishte fatqësisht debati "turko-arabë", i cili përkeqësohet më tepër kur kalon në duart e xhematit. Në debatet e bëra nëpër tavolina u

reflektua gjallërisht tendenca e pan-turkistave me pan-arabët, ndërkaq shqetësimi më i madh për ne duhej të ishte unifikimi i datës me të cilën do të festohej në të gjitha trojet shqiptare njësoj, si dhe në mbarë Ballkanin e botën. Shumë interesante ishte një letër e drejtuar nga Reis Ulemaja e Bosnje-Hercegovinës prof. dr. Mustafa Ceriq, i cili iu drejtua këtyre autoriteteve kështu, po e citoj:

I nderuari kryemyfti Sheikh Abdulaziz Al al-Shaikh, I nderuari kryemyfti Mehmet Görmez.

Kemi marrë vendimet tuaja, të cilat flasim për dallimet tuaja rreth ditës së parë të muajit dhul-hixhxe të këtij viti (1433 hixhri), rreth ditës së Arafatit, dhe ditës së parë të Kurban Bajramit.

Argumentimi Këshillit të lartë të ulemasë të Mbretërisë së Arabisë Saudite se nuk ishte e mundur të shihet hënën e re para përfundimit të 30 ditëve nga muaji dhul-ka'de është e kuptueshme dhe e pranueshme për popullin e Arabisë, por nuk është e kuptueshme dhe as e pranueshme për popujt tjerë. Gjithashtu, argumentimi Administratës së përgjithshme të çështjeve fetare të Republikës së Turqisë, se nuk është e mundur të ndryshohet takvimi i bërë sipas llogaritjeve të sakta të kohës është e kuptueshme dhe e pranueshme për Turqinë, por nuk është e kuptueshme dhe as e pranueshme për pjesën tjetër të botës, sepse haxhi dhe kurban janë adhurime që veçohen nga koha dhe vendi, e këto janë Dita e Arafatit, sipas hadithit në të cilin thuhet: "Haxhi është Arafati!"

Një vërejtje interesante kjo e të nderuarit Ceriq, i cili e ka vënë gishtin në plagë dhe e ka nxjerrë në pah thelbin e këtij debati. Nuk mund të lemë pa përmendur këtu trashëgiminë osmane, e cila ngriti institucione të posaçme si Munexhimbashilliku (Zyra e Kryeastronomit perandorak), si dhe



Muvakithanet (Vendet që i kushtoheshin përcaktimit të saktë të kohëve të faljes quheshin muvakithane) e Muvakitët (Matësit e Kohës - përgatitnin kalendare dhe përcaktonin ditën e fillimit të muajit të Ramazanit). Gjatë kësaj kohe edhe Arabët kanë qenë pjesë e Perandorisë Osmane, por nuk mund të mos vërejmë këtu, se këta Arabë sot kanë përparuar dhe kanë observatorët dhe satelitët e tyre në hapësirën përreth tokës. Kështu debati në terren këtu te ne përfundoi që përfaqësuesit e KMSH-së, kryetari për Tiranën Ylli Gurra në Klan TV me siguri iu referua përlllogaritjeve të bëra nga observatori zyrtar i Kandilisë dhe për këtë nuk ka asgjë të keqe deri këtu përderisa ne do të ndjekim vendimin e Dijanetit Turk.

Por të gjitha këto u acaruan shumë ngaqë hyri në mes edhe media, e cila pa dashje duke u marrë me këtë problem e ndezi atmosferën tonë këtu, duke i fryrë zjarrin në përballjen "turq" e "arabë", apo edhe dikush në blogjet sociale iu referua ndarjes për datën Shqipëri-Kosovë datave 28-29 nëntor të çlirimit për të cilat kanë kundërshtime të majtët e të djathtët. Ajo çka u bë më shqetësuese në këtë rast ishte nacionalizimi i tepruar i 25 tetorit dhe ajo që i irritoi njerëzit ishte, se në një masë të madhe ata prisnin nga institucioni zyrtar, që të ndërronin datën. Ajo çka morën njerëzit ishin disa justifikime të vakëta,

ku fraza "përlllogaritje astronomike" ishte kryefjala e justifikimit dhe nënteksti "ata- të tjerët" vejnë dorën në ballë për të parë hënën me një nuancë të dallueshme talljeje (madje me humor dikush tha që duhet të rikthejmë orën diellore). "Ne kishim një marrëveshje me Kosovën më datë 25", por ato nuk e mbajtën marrëveshjen. Institucioni kryesor heshti pa dhënë asnjë shpjegim për të gjithë këtë gurgule mediatike, duke e lënë xhematin në pjesën më të madhe të hutuar dhe duke e dëmtuar imazhin e vet përsëri. Në gjithë këtë rrëmujë të krijuar në këto ditë, nuk është e rëndësishme se kush ia qëlloi datën, sepse "tek Allahu nuk mbërrin, as gjaku, as Kurban, por mbërrin devotshmëria", dhe se "Allahu nuk sheh fizionominë e njerëzve, porse sheh zemrat tona". Allahu na faltë të gjithë neve...

* Ky shkrim paraqet qëndrimin personal të autorit.

Festa e fëmijëve të Tiranës për Kurban Bajram

Tashmë është bërë një traditë e mirë që fëmijët e xhamive të Tiranës të festojnë të gjithë së bashku me rastin e këtyre dy festive të rëndësishme vjetore. Ato u mblodhën sivjet përsëri në ambientet sportive të Universitetit të Sporteve në Tiranë, ku mësuesja dhe njëkohësisht organizatorja e kësaj feste tradicionale Enkeleda Matraku kishte përgatitur një program të pasur me këtë rast, së bashku me një grup të madh fëmijësh tiranas. Me rastin e Kurban Bajramit tema qendrore e këtij manifestimi ishte "Unë e dua profetin tim Muhamedin alejhi selam". Gjatë fjalës përshëndetëse dhe gjatë të gjithë kësaj veprimtarie fëmijët kanë performuar duke nxjerrë në pah cilësitë e vyera të profetit Muhamed: "Ai ishte i butë, ai ishte besnik, ai ishte trim..." etj. Fëmijët recituan dhe festuan duke ia shtuar kënaqësinë dhe gëzimin kësaj dite feste, e cila u bë më e pasur edhe në saje të programit të pasur të kësaj veprimtarie. Kjo festë organizohet që prej tre vitesh me ndihmën e Xhamive të Tiranës, të cilat ndihmojnë me stafin përgatitor, idetë dhe me financime për realizimin e saj.



Boshnjaku Senad Haxhiç shkon për në Meke nëpërmjet Sirisë



Një boshnjak ka ecur 5,650 km për të kryer haxhillëkun në Meke të Arabisë dhe thotë se Allahu e ka ruajtur atë nga lufta në Siri.

Senad Haxhiç 47 vjeç i ka treguar reporterit të BBC, se ka shpenzuar disa orë në kufirin sirian për të marrë një vizë. Më pas ai ka negociuar për rrugën e tij në shumë pika kontrolli – disa të manaxhuara nga ushtria e disa nga rebelët. "Disa prej tyre deri edhe puthën Kuranin tim," - thotë ai duke shtuar se ai gjithashtu kishte një Bibël në çantën e shpinës. "Haxhillëku në Meke është një nga pesë shtyllat e Islamit - një detyrim që Muslimanët pritët ta kryejnë të paktën një herë në jetën e tyre." Haxhiç vjen nga një qytet i vogël pranë kryeqytetit boshnjak Sarajevës dhe sprovenë e parë të vështirë e

ka kaluar dhjetorin e kaluar në Bullgari në temperatura minus 350 celsius, - i tregon reporterit të BBC Dan Damon. "Nuk kam pasur një ditë të vetme të qetë, çdo ditë ka qenë e vështirë, por ë të njëjtën kohë ka qenë nxitëse," - tregon ai. Pasi kisha marrë vizën siriane, - rrëfen ai, - një oficer i ushtrisë së presidentit Beshar Asad më kërkoi mua "të lutem për atë në Meke, nëse do të dilja i gjallë nga Siria". Rruga ndërmjet kufirit nga hyra unë dhe qytetit të Halepit ishte e mbushur me shkëmbinj të mëdhenj. Rebelët i kishin hedhur shkëmbinjte për t'ua bërë të pamundur lëvizjen makinave dhe autobuzëve. Njerëzve me familjet e tyre thjesht iu duhej të linin makinat e tyre.

Ai thotë se të kishe një vizë siriane "nuk do të thoshte asgjë - një luftëtar

rebel nga ndonjë cep fushe dhe të kërkonte pasaportën. Askush nuk më qëlloi. Mua më ndalonin njerëz të armatosur, që më kontrollonin pasaportën, por kur iu thoshja se isha në rrugë të Allahut, qoftë rebelët, qoftë ushtarët e presidentit Asad më linin të vazhdoja.

Haxhiç thotë se ai i mbante si Kuranin dhe Biblën, "sepse unë jam shumë fetar". Nëse unë nuk do të besoja që Zotin e kam me vete, se ai po më mbronte dhe po më udhëzonte mua, unë nuk do të kisha arritur në Bullgari e jo më të arrija në Meke.

Unë kam ecur përmes shtatë shteteve, dy shkretëtirave, kam përshkuar 5,650 km pa pasur shumë para, vetëm me një çantë shpine që peshonte 20 kilogram, - ka rrëfyer ai për BBC.

Islami lufton dembelizmin dhe papunësinë

Nga Sokol KONDAKÇIU

Feja islame është një sistem jetese dhe nuk është një fe me korniza të ngushta, të cilat kufizohen në konturet e faltore, ku ne kryejmë çdo ditë ibadetet më të rëndësishme faljen e namazit, ose ritet e tjera fetare. Feja Islame është një sistem i plotë jetese, i cili përfshin të gjitha sferat dhe rrafshët e jetës, që nga lindja e deri në vdekjen e tij. Feja Islame i nxit besimtarët e vet nëpërmjet ajeteve kuranore dhe porosive profetike të jenë të dobishëm në një shoqëri, duke u angazhuar në punë të ndryshme në profile dhe profesione të ndryshme. Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: “Thuaj (o Muhamed) punoni, se punën tuaj do të dëshmojë për te Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët.” (Teubeh, 105). Ne nxitemi kështu për të punuar, për të kryer të gjitha punët dhe obligimet fetare, dhe gjithashtu punë prej të cilave ka dobi individit dhe shoqëria në të cilën jetojmë.

Sa i përket punës nëpërmjet së cilës ne kërkojmë rizkun tonë të premtuar nga Allahu i Madhëruar ai arrihet duke punuar dhe duke e kërkuar atë, e për këtë Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: “Ai (Allahu) është krijuesi që tokën e bëri të nënshtruar ndaj jush (në shërbimin tuaj) ecni në gjerësinë e saj dhe hani prej të mirave të saj dhe tek Ai (Zoti juaj) do të jetë kthimi.” (El Mulk 15). Nëse do ta hedhim shikimin tek të parët tanë muslimanë ne do të shohim, se ata ishin të angazhuar në jetën e tyre si në adhurimin e Zotit, si dhe në punën e tyre në sigurimin e jetesës së tyre, edhe pse synimi i tyre ka qenë arritja e kënaqësisë së Allahut dhe fitimi i botës së amshueshme. Edhe pse ata sakrifkuan për këtë fe me jetën dhe pasurinë e tyre ata nuk harruan pjesën e kësaj dunjaje duke punuar dhe duke u përpjekur për të siguruar jetesën dhe rizkun e tyre. Ata ishin të frymëzuar nga mësimet dhe parimet e Fesë Islame të marra nga profeti Muhamed, të cilin e kishin pranë dhe kjo bëri që ata ta kuptonin drejt vërtetësinë e kësaj feje. Profeti Muhamed (a.s.) ka thënë: “Nëse shikoni se erdhi Kiameti dhe në dorë keni një fidan mbillenit atë”. Feja Islame na nxit, që ne të punojmë dhe të jemi të dobishëm në jetën tonë për veten, familjen, si dhe shoqërinë pjesë e së cilës jemi. Papunësia është një fenomen negativ i shoqërisë dhe shkaqet e saj janë të ndryshme, prej tyre papërgjegjshmeria e shtetit dhe e politikanëve, të cilët nuk interesohen për përmirësimin e gjendjes ekonomike të vendit të tyre. Prej shkaqeve të papunësisë janë dhe krizat e ndryshme ekonomike, si kjo e ditëve të sotme, e cila vjen si pasojë e sistemeve bankare, të cilat në bazë kanë interesin dhe kamatën. Ato janë cilësuar në Kuran si diçka në të cilën nuk ka bërëqet dhe e falimentueshme. (Allahu e rrit vlerën e sadakasë dhe e fshin vlerën e kamatës). Një nga shkaqet e papunësisë është dhe dembelizmi dhe mos-angazhimi në punë të ndryshme prej të cilave vjen dobia dhe siguri i jetesës, duke u argumentuar se Allahu është furnizuesi dhe vetëm në saje të

devotshmërisë që kanë do t'i furnizojë ata. Është e vërtetë se ata që janë të devotshëm ndaj Zotit të tyre, duke qenë të bindur ndaj tij në obligimet fetare dhe duke u larguar nga çdo e keqe do të furnizohen me rizk prej Tij, por a mos do të thotë kjo, se ne nuk duhet të punojmë?... Nëse do të hedhim një vështrim mbi profetët, të cilët Allahu i dërgoi lajmëtarë për të vërtetën mbi popujt e tyre, ne do të shohim se ata kanë qenë të specializuar në një punë të caktuar. Disa prej tyre kanë qenë barinj, prej tyre marangozë, disa kovaçë, tregtare etj. Të gjithë profetët kanë qenë njerëzit më të devotshëm të kohës së tyre, ashtu siç ka thënë profeti yne Muhamedi (a.s.): “Unë jam më i devotshmi dhe më i frikësuar ndaj Allahut sesa ju”. Edhe pse të devotshëm ata kanë pasur profesion ose zanat me të cilin kanë punuar. Profeti Daud (a.s.) ka qenë farkëtar. Ai prodhonte veshje prej hekuri, që shërbenin për luftë, ndërkohë që ishte mbret. Ai ishte mbreti që nuk pranonte të përfitonte vetëm se nga puna e dorës së tij. Puna është e domosdoshme dhe duhet bërë një ekuilibrim midis përkushtimit tonë fetar ndaj Zotit dhe punës tonë për këtë botë. Dembelizmi dhe papunësia nuk është cilësi e muslimanit. I Dërguari i Allahut kur pa një burrë prej ensarëve, i cili lypete në rrugët e Medines i tha: “Çfarë plaçke ke në shtëpi? - Ai i tha: -Kam një shtroje. Atë e shtrojmë dhe me atë mbulohe mi dhe një broke uji. - I thotë atij: -Shko merri dhe m'i jep mua, - e më pas kur ia solli i tha shokëve të tij: -Kush i blen këto të dyja, - e dikush tha unë i blej me një dërrhem, profeti tha dikush tjetër që i blen më shumë! Dikush tjetër tha unë i blej me dy dërrhem. Ai i mori dhe ia dha atij lypësi dhe i tha: -Me një dërrhem bli ushqim për familjen dhe me një dërrhem bli një sëpatë dhe eja tek unë. - Kur shkoi te profeti i vendosi një bisht dhe i tha: -Tani shko e bëj dru dhe mos të të shoh për 15 ditë, - dhe kur ai u kthye pas 15 ditësh kishte mbledhur 10 dërrhem, dhe me to bleu roba e ushqim për familjen...”.

Duke u nisur nga ky hadith ne kuptojmë, se Islami si sistem nxit punësimin dhe është kundër dembelizmit dhe papunësisë, ose t'i lesh pas dore punët e kësaj bote. Muslimanët e parë ishin besimtarë të devotshëm dhe punëtorë, dhe kërkues njëkohësisht. Ata arritën me këtë fe, me këtë Kuran të ishin të parët në kohën e tyre, duke arritur majat e diturisë, nga ku u bënë mësues dhe dhënës diturie për të gjithë Evropën në kohën e lulëzimit Islam andaluzian. Duhet që një besimtar musliman të jetë kërkues, të mësojë e të specializohet në një fushë të caktuar për të qenë pjesë plotësuese në shoqëri me punën dhe profesionin e tij. Nga ana tjetër muslimani duhet të jetë bashkëpunues; të pasurit që kanë pasuri të bashkëpunojnë me ata që janë të specializuar dhe të diplomuar në fusha të ndryshme për të hapur punë prej të cilave shpresojnë të mirat materiale të kësaj bote. Nga ana tjetër dikush që di ndonjë

zanat të jetë kontribues për t'ia mësuar atë dikujt tjetër, nëse nuk mundemi që ta ndihmojmë dikë me pasuri të paktën me dituri të dobishme me ndonjë zanat dhe kjo është sadaka e rrjedhshme e njëkohësisht dhe sevapi i saj vazhdon me vazhdimin e punës edhe pas vdekjes. Për këtë i Dërguari i Allahut thotë: “Kush e ka ndonjë mirësi t'i japë të përfitojë prej saj dikujt që nuk e ka, e kush ka furnizim t'i japë të përfitojë atij që nuk ka.” Muslimi.

I Dërguari i Allahut thotë: “Allahu i Madhëruar e don robin e tij të jetë me profesion (i specializuar në një punë)”. Trasmeton Ashab Sunen.

Dua të them se fenomeni i papunësisë, ose i dembelizmit tek një pjesë e muslimanëve ndikon negativisht tek ata që nuk janë muslimanë, duke menduar se feja jonë është e tillë, ngase pasuesit e saj veprojnë kështu. Shumë njerëz mendojnë, se ata që shkojnë dhe falen në xhami nuk kanë punë tjetër veç kësaj dhe se ata janë dembelë dhe nuk e duan punën. Kjo na kujton atë që ka ndodhur në kohën e Omer ibn Hatabit, i cili gjeti ca djem në xhami që rrinin aty tërë ditën, dhe kur Omeri (r.a.) i pyeti, se pse vepronin kështu ata i thanë: -Ne adhurojmë Allahun, - e kur i pyeti se ku ushqeheni ju, ata i thanë: -Njerëzit tanë të afërm dhe fqinjët na ushqejnë, - atëherë

u detyrua t'i nxjerrë nga xhamia duke iu thënë: -Dilni e kërkoni rizkun, se feja jonë nuk është kështu.-

Një herë tjetër Omeri ka gjetur njerëz ditën e xhuma në xhami dhe kur i pyeti, se çfare jeni ata i thanë jemi të mbështetur tek Allahu. Ai iu thotë ju jeni dembela, mos rriini ulur dhe të thoni: O Zot më jep furnizim, - sepse qielli nuk lëshon, as ar, as argjend! A nuk e keni dëgjuar fjalën e Zotit, që thotë: “E kur të kryeni namazin e xhumasë, shpërndahuni nëpër tokë dhe përfitoni nga të mirat e saj.” (Xhuma, 10).

Gati çdo ditë ne përballemi me kritika, ku në qendër të vëmendjes janë ata besimtarë që shihen të qëndrojnë me orë të gjata në oborret e xhamive dhe nuk merren me ndonjë punë të dobishme për t'i ardhur në ndihmë vetes, familjes, si dhe për të qenë të dobishëm për shoqërinë. Ndodh që mund të bëjmë për këtë fe më shumë me punën dhe profesionin tonë, sesa me qëndrimin tonë, sesa me fjalët tona dhe davetin tonë.

Si mund të ndihmohet feja e Zotit, nese do të jemi të dobët dhe të pafuqishëm?

Në fund po e mbyll këtë shkrim me ajetin kuranor në të cilin Allahu i Madhëruar thotë: “Bashkëpunoni në punë të mira dhe në devotshmëri e mos bashkëpunoni në punë të këqija dhe në armiçësi.” (Maide, 2).

Hap i ri nga Palestina

Palestina po bën gati kërkesën e shtetësisë pa qenë anëtare e OKB-së.

Bëhet e ditur se Kryetari i shtetit palestinez, Mahmud Abas, pavarësisht kërcënimeve që vijnë nga SHBA-ja dhe Izraeli për prepezalje financiare dhe diplomatike po përgatitet të aplikojë muajin e ardhshëm për të fituar statusin e shtetit, por duke mos qenë anëtar i OKB-së. Tevfik Tiravi, një nga pjesëtarët e lëvizjes Fetah, tha se nuk do të dëgjojnë asnjë kërcënim dhe do t'ia drejtojnë kërkesën e shtetësisë OKB-së. “Izraeli do të mundohet të na ndëshkojë në rast se ne e fitojmë statusin e shtetit. Por kjo gjithsesi është përzgjedhja jonë dhe nuk do të tërhiqemi”, shtoi ai. Kurse një zyrtar palestinez që preferoi të mbetej anonim tha se Abasi kërkesën në fjalë Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së do t'ia parashtrijë në datën 15 ose 29 nëntor. Të dyja datat kanë një rëndësi simbolike për Palestinën. Në 15 nëntor të vitit 1988 Palestina ka shpallur pavarësinë. Kurse në 29 nëntor të vitit 1947 OKB-ja kishte vendosur ndarjen në dy pjesë të territoreve palestineze, që në atë kohë ndodheshin nën administrimin britanik, në territore izraelite dhe territore arabe. Pas këtij vendimi, të pranuar nga Izraeli dhe të kundërshtuar nga arabët, nisën luftërat, në të cilat u përfshinë shumë vende. OKB-ja 29 nëntorin e feston si ditën e solidaritetit me palestinezët. Ndërkaq Abasi tha se bisedimet e paqes mund ti

rifillojnë përsëri pas votimit që do të bëhet në Asamblesë të Përgjithshme të OKB-së. Në fjalën e tij të mbajtur në sesionin e 67-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, Presidenti i Palestinës, Mahmud Abbas tha se do të kërkojnë që statusi i vendit të tij nga “vëzhgues” të kthehet në statusin e “vendit jo-anëtar”. Mahmud Abbas preku edhe në problemet që jetohej me izraelitët dhe shtoi se aktivitetet e ndërtimit të vendbanimeve çifute dëmtojnë shansin e zgjidhjes me dy shteteve. Abbas nënvizoi se tanimë në dorë kanë shansin e fundit për të shpëtuar paqen dhe paralajmëroj se aktivitetet e ndërtimit të vendbanimeve çifute në territoret e okupuara do të sjellë një fatkeqësi të re për popullin palestinezë. Ndërkaq pas liderit palestinezë, Mahmud Abbas fjalën e mori Kryeministri i Izraelit Benjamin Netanjahu, i cili përsëriti se dalin kundër njohjes së Palestinës si shtet. Netanjahu i bëri thirrje liderit palestinez të ulen sërish në tavolinën e negociatave.



Click to go back, hold to see history

Etëna: 29 Tetor 2012

search...

Kryefaqja Deklarata Rreth Nesh Aktivite Projekt Donacion Kontakt

Uniteti është mëshirë ndërsa përçarja është dënim

LIDHJA E HOXHALLAREVE TE SHQIPERISE

رابطة أئمة البانيا

YouTube

Channel Settings Analytics Video Manager

lidhjaehoxhallareve's channel

61 subscribers 30,877 video views

Featured Browse videos

About lidhjaehoxhallareve's channel

- LIDHJA E HOXHALLAREVE
- KUSH JEMI NE
- STUDIME
- DERGO PYETJE
- PYETJE PERGJIGJE
- DEKLARATA
- PROJEKTE
- KONTAKT

By lidhjaehoxhallareve

Latest Activity Oct 29, 2012

A.-M.-B.-C

ALBANIAN MUSLIM BUSINESS CENTRE

www.lidhjatregtareve.com



DYQANI I MISHIT "HALLALL"

- ✓ Tregton mish vici, qengji, qofte dhe sallameri të firmës "Meka", me shumicë dhe pakicë.
- ✓ Ofron qengja për kurbanë dhe akika.

Adresa: Rr. "Bedri Cullhaj", tek Goni, pranë Xhamisë së Kombinatit
 Tel: 04 2350569; Cel: 0672050070
 Email: agronxhepa@hotmail.com

DYQANI I MISHIT "HALLALL", Kombinat